



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P-070
Prishtinë, më 14 korrik 2016, ora 10:00

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 14 KORRIK 2016**

Seancën e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit dhe i ndihmoi Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të caktuar me vendim të seancës plenare, më 7 korrik 2016.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 72 deputetë dhe janë plotësuar kushtet për punë.

Kryetari i GP të LDK-së, Ismet Beqiri, propozoi që rendi i ditës të plotësohet edhe me një pikë shtesë: *Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet KFW Frankfurt am Main dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për programin “Masat e eficientës së energjisë në ndërtesat publike në nivel komunal në Kosovë”.*

Pas deklarimit të kryetarëve të grupeve parlamentare, kryetari e hodhi në votim propozimin e lartshënuar.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për ----- 80,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash vendosi që rendi i ditës i kësaj seance të plotësohet edhe me këtë pikë: *Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet KFW Frankfurt am Main dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për*

programin “Masat e eficiencyes së energjisë në ndërtesat publike në nivel komunal në Kosovë”.

Kryetari më pas procedoi me rendin e ditës, si në vijim:

1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet KFW Frankfurt am Main dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për programin “Masat e eficiencyes së energjisë në ndërtesat publike në nivel komunal në Kosovë”

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet KFW Frankfurt am Main dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për programin “Masat e eficiencyes së energjisë në ndërtesat publike në nivel komunal në Kosovë” dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ministri i Financave, z. Abdullah Hoti, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet KFW Frankfurt am Main dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për programin “Masat e eficiencyes së energjisë në ndërtesat publike në nivel komunal në Kosovë”.

Pas prezantimit të projektligjit nga ministri i Financave, kryetari e hapi diskutimin për këtë projektligj.

Lidhur me Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet KFW Frankfurt am Main dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për programin “Masat e eficiencyes së energjisë në ndërtesat publike në nivel komunal në Kosovë” diskutuan: Naser Osmani, në emër të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa dhe të GP të LDK-së, Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së; Shqipe Pantina, në emër të GP të VV-së, Slavko Simiq, në emër të GP Lista serbe; Fikrim Damka, në emër të GP “6 +”, deputeti Nait Hasani dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, z. Blerand Stavileci, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari sqaroi procedurat se për miratimin i këtij projektligji kërkohen së paku 80 vota “për” dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.

Kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet KFW Frankfurt am Main dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për programin “Masat e eficiencyes së energjisë në ndërtesat publike në nivel komunal në Kosovë”.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 87,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 1.

Kuvendi e miratoi Ligjinnr. 05/L-107 për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet KFW Frankfurt am Main dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për programin “Masat e eficiencyes së energjisë në ndërtesat publike në nivel komunal në Kosovë”.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-109 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-071 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa dhe të komisioneve të përhershme për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-109 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në këtë projektligj ishin paraqitur 21 amendamente. Amendamentet nga 14 deri 21 nuk e kishin mbështetjen e Komisionit FunkSIONAL.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet veç e veç, sipas radhitjes nga ana e Komisionit FunkSIONAL.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, (i riformuluar) 13, 15, 18, 19 dhe 21.

Deputetja Xhevahire IzmaKu e tërhoqi nga procedura amendamentin nr. 16.

Deputeti Qerim Bajrami e tërhoqi nga procedura amendamentin nr. 20.

Kuvendi nuk i miratoi këto amendamente: 14 dhe 17.

Lidhur me Projektligjin nr. 05/L-109 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-071 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 dhe amendamentet: 6, 10, 12, 14, 15, 17, 18, 19 dhe 21, diskutuan: Naser Osmani, ministri Abdullah Hoti, Kadri Veseli, Muhamet Mustafa, Armend Zemaj, Vjosa Osmani, Fatmir Rexhepi, Melihate Tërmmkollli, Safete Hadërgjonaj, Jasmina Zhivković, Qerim Bajrami, ministri Arsim Bajrami, Emilija Rexhepi, Bekim Haxhiu, ministri Kujtim Shala, Ismet Beqiri, Ganimete Musliu, Mexhide Mjaku-Topalli, Blerta Deliu-Kodra, Nait Hasani, Duda Balje, Nuredin Ibishi dhe Ali Sadriu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në fund, kryetari e hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 70,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 2.

Kuvendi e miratoi Projektligjin nr. 05/L-109 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-071 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-108 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare, në pajtim me vendimin e seancës plenare, të mbajtur më 7 korrik 2016, e kanë shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-108 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentin e propozuar.

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, z. Naser Osmani, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në këtë projektligj, Komisioni FunkSIONAL e kishte propozuar vetëm një (1) amendament.

Kryetari e hodhi në votim amendamentin e Komisionit FunkSIONAL.
Kuvendi e miratoi amendamentin nr. 1.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentin e miratuar.
Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----65,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 1.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-108 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal.

4. Shqyrtimi i raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin për shqyrtim dhe miratim.

Kryesuesi e ftoi guvernatorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës që ta paraqesë raportin.

Guvernatori i BQK-së, z.Bedri Hamza, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2015, fjalimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Kryesuesi i Komisionit për Buxhet dhe Financa, z. Naser Osmani, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2015.

Lidhur me raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2015 diskutuan: Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së; Naser Osmani, në emër të GP të LDK-së; Shqipe Pantina, në emër të GP të VV-së, si dhe deputetët Salihe Mustafa, Armend Zemaj, Faton Topalli, Muhamet Mustafa, Fatmir Rexhepi dhe Bislim Zogaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Para se të hidhej në votim, kryesuesi konstatoi se në sallë janë të pranishëm 59 deputetë.

Votimi i raportit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2015 shtyhet për seancën e radhës.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës plenare në orën 16:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*